



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

L ë n d a: Mbledhja e Komisionit Kombëtar të Nomenklaturave

KKN

Minutat e takimit

Datë 22.12.2022

Më datë 22 Dhjetor u zhvillua mbledhja e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturat (KKN). Axhenda e takimit ishte:

1. Raportim nga Ministria e Arsimit dhe Sportit mbi “Klasifikimin Standard Ndërkombëtar Të Arsimit KSNA 2011 (ISCED 2011), të Fushave të Arsimit dhe të Trajnimit të KSNA 2013 (KSNA-F 2013)”
2. Raportim nga Ministria e Drejtësisë mbi “Klasifikimin Ndërkombëtar të Krimeve për Qëllime Statistikore, ICCS;
3. Prezantim i projektplanit të aktiviteteve të KKN-së për vitin 2023;
4. Çështje të tjera.

Në mbledhje ishin prezent 19 anëtarë të KKN.

Kryetarja e KKN, Znj. Elsa Dhuli pasi i uroi mirëseardhjen tre anëtarëve të rinj e quajti mbledhjen të hapur. Pas miratimit të axhendës nga të gjithë anëtarët, mbledhja vijoi sipas rendit të ditës.

Raportim nga Ministria e Arsimit dhe Sportit mbi “Klasifikimin Standard Ndërkombëtar Të Arsimit KSNA 2011 (ISCED 2011), të Fushave të Arsimit dhe të Trajnimit të KSNA 2013 (KSNA-F 2013)

Znj. Ornela Koleka me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, anëtare e re e KKN-së pas komunikimit me drejtoritë respektive të angazhuara për procesin e zbatimit të ISCED raportoi që:

- Përsa i përket statistikave në fushën e arsimit parauniversitar ato janë në përputhje të plotë me ISCED;

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- Ndërkohë përse i përket statistikave në fushën e arsimit të lartë, aktualisht MAS po bën kodifikimin e programeve të arsimit të lartë. Ky kodifikim do përshtatet me të gjithë spektrin e ISCED.
- Kodifikimi është një proces që pritet të mbarojë shpejt sepse po ecën me ritme të kënaqshme;

Znj. Koleka shtoi me tej që angazhimi që MAS po kryen për zbatimin e ICED po ecën në linjë të drejtë dhe shumë shpejt ky proces do të finalizojë mënyrën e raportimit në përputhje me ISCED.

Znj. Dhuli e quajti arritje miratimin e klasifikimit ISCED me një akt ligjor i cili detyron të gjithë institucionet që lidhen me këtë lloj klasifikimi ta zbatojnë atë sipas të gjitha kërkesave.

Raportim nga Ministria e Drejtësisë mbi “Klasifikimin Ndërkombëtar të Krimeve për Qëllime Statistikore, ICCS

Në takim ishin të pranishëm tre pjesëtar nga Ministria e Drejtësisë, Znj. Brikena Qela anëtare e KKN-së si dhe dy ekspertë, gjithashtu pjesë e grupit të punës së klasifikimit ndërkombëtar të krimeve (i njohur si ICCS në vazhdim).

Znj. Brikena Qela prezantoi punën e kryer për klasifikimin ICCS. Grupi i punës ka përfunduar hartëzimin e 11 kapitujve në përbërje të tij. Gjatë analizimit të minutave të takimit të fundit të organizuar nga grupi teknik i punës janë evidentuar problematika në implementimin e ICCS dhe shkak janë mospërputhjet e definicioneve të ICCS me kodin aktual penal.

Më tej fjalën e mori Znj. Tatjana Janku, specialiste në Sektorin e Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, gjithashtu dhe pjesë e grupit të punës të ngritur për zbatimin e ICCS. Ndër të tjera Znj. Janku raportoi se:

- Grupi ndërinstitutional për klasifikimin e ICCS ka vite që punon për klasifikimin në fjalë;
- Është arritur në përfundim që të bëjmë një klasifikim duke ju përmbajtur kodit tonë penal aktual;
- Gjatë punës janë evidentuar problematika teknike si mospërputhje me kodin penal (por jo kodit në themel të tij), por klasifikimit që kërkon disa specifika të veçanta;

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- Për momentin nuk ekziston një sistem i ndërlidhur elektronik që të lidh gjithë hallkat e gjyqësorit me njëra tjetrën;
- Policia ka një sistem të menaxhimit të çështjeve të tyre dhe ku ndarja e neneve bëhet sipas kodit tonë penal dhe jo sipas paragrafeve ose specifikave të veçanta;
- Prokuroria gjithashtu ka një sistem ende jo funksional për shkaqe teknike edhe pse e ka paksa më të thjeshtë ti përshtatet këtij klasifikimi sepse hetimi hyn në thellësi dhe kështu mundet mund të arrijë t identifikoj një pjesë të madhe ndarjes që klasifikimi ICCS ka;
- Gjykatat kanë një specifikë tjetër ku ende janë pa një sistem të menaxhimit të çështjeve ku në pjesën më të madhe punohet në mënyrë manuale. Pra, klasifikimi ICCS nuk arrin dot e para të regjistrohet sipas specifikave të tij.
- Kodi penal aktual është në një proces rishikimi e do të ketë në të ardhme përcaktime më të thelluara se sa i ka tani. Përfundimi i rishikimit nuk dihet ende duke qënë se janë vendimmarje të një niveli më të lartë;
- Për mënyrën e mbledhjes së të dhënave statistikore është menduar përfshirja e Këshillit të Lartë Gjyqësor në grupin ndërinstitutional, jo vetëm si institucion që ka gjykatat në varësi por ka një shtritje më të gjërë mbi gjykatat;
- MD transmeton të dhëna me institucione ndërkombëtare por jo në bazë të klasifikimit ICCS. Të dhënat administrative mbledhen dhe transmetohen në bazë të kodit aktual penal;
- Në mbyllje të raportimit, propozimi i ekspertit të grupit të punës ishte që të pritej miratimi i ndryshimeve në kodin penal. E njëjta kërkesë ka ardhur dhe nga Ministria e Brendshme.

Znj. Dhuli theksoi dhe një herë punën voluminoze të bërë nga grupi i punës lidhur me klasifikimin ICCS. Më tej Znj. Dhuli propozoi që klasifikimi të mbahet në situatën që është deri sa kodi penal të finalizohet.

Të gjitha vendet evropiane prodhojnë statistika të krimeve në bazë të kodit të tyre kombëtar penal. Organizata Kombëtare për Krimin Dorgën dhe Korrupsioni (UNDC) ka propozuar që të gjitha vendet në mënyrë që statistikat e tyre të jenë të krahasueshme, pra ti klasifikoj të dhënat në bazë të këtij klasifikimi. Por në fazën që kodi penal po rishikohet dhe kemi gjithashtu një organizim nga ana e gjyqësorit dhe strukturave të tjera që lidhen me këto statistika mbase do ishte e drejtë që puna për ICCS të qëndroj pezull deri sa këto procese të finalizohen. Anëtarët shprehen dakortësinë e tyre.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Znj. Janku edhe një herë theksoi rëndësinë e përfshirjes së KLGJ në këtë proces si njohës të mirë të kapacitetve të gjykatave.

Prezantim i projektplanit të aktiviteteve të KKN-së për vitin 2023

Në vijim Znj. Dhuli prezantoi projektplanin e aktiviteteve të KKN-së për tu zhvilluar gjatë vitit 2023. Në çdo fillim viti kërkohet nga të gjitha ministratë dhe institucionet gjithashtu nga drejtoritë dhe sektorët e INSTAT, nëse kanë klasifikime të reja ose klasifikime në proces rishikimi. Në sekretariatat parqiten kërkesat të cilat diskutohen në takimin e parë të KKN-së 2023. Aktivitetet e planifikuara u prezantuan nga Znj. Dhuli.

Për anëtarët e rinj të pranishëm në mbledhje, në fund të takimit Z. Maldi Dema, Drejtor në Drejtorinë e Koordinimit dhe Çështjeve Ligjore pranë INSTAT-it bëri një prezantim të shkurtër mbi natyrën e punës, rolin dhe detyrat e Komisionit Kombëtar të Nomenklaturave sipas legjislacionit për statistikat zyrtare.

Përgatiti:

Sekretariati i KKN

29 dhjetor 2022

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al